



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E PEJËS MUNICIPALITY OF PEJA OPŠTINA PEĆ

KUVENDI I KOMUNËS SË PEJËS

Komiteti për Politikë dhe Financa

Nr. Protokolit: 060101-49293

Data: 10.07.2025

Për: Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa – KPF

FTESË

Të nderuar anëtar/e,

Ju ftojme që të merrni pjesë në mbledhjen e VI-të të Komitetit për Politikë dhe Financa për vitin 2025. Mbledhja do të mbahet me dt. 17.07.2025 (Enjte), ora: 11:00, në sallën e Komitetit për Politikë dhe Financa.

Vërejtje: Komiteti për Politikë dhe Financa mbanë të drejtën për ta aplikuar nenin 45, paragrafin 3, të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nëse kjo gjë shihet e nevojshme.

RENDI I DITËS

1. Aprovimi i rendit të ditës.
2. Shqyrtimi dhe miratimi i Procesverbalet të KPF-së: dt. 15.05.2025 dhe dt. 18.06.2025.
3. Shqyrtimi dhe rekomandimi i Nismës për bashkëpunim Komunal Ndërkombëtar në mes të Komunës së Pejës nga Republika e Kosovës dhe Komunës së Buca nga Republika e Turqisë.
4. Shqyrtimi dhe rekomandimi i raportit të punës së Kryetarit të Komunës për gjashtë-mujorin e parë 2025.
5. Shqyrtimi dhe rekomandimi i raportit të hyrave dhe shpenzimeve për gjashtëmujorin e parë, janar - qershor 2025.
6. Shqyrtimi dhe rekomandimi i raportit të auditimit për pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Pejës për vitin 2024 dhe plani i veprimit për të gjeturat e auditimit të viti 2024.
7. Shqyrtimi dhe rekomandimi i informatës nga DKA për përfundimin e vitit shkollor, testit të arritshmërsisë dhe testit të maturës.
8. Pytjet dhe propozimet lidhur me punën e Komunës, të ngritura nga anëtarët, në atë rënditje siç janë pranuar. (Për tu dorëzuar të Sekretari jo më vonë se të Merkurë, me dt. 16.07.2025).



KUVENDI I KOMUNËS SË PEJËS

Adresa: Rr. Hasan Prishtina

Tel: 03820043433



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E PEJËS MUNICIPALITY OF PEJA OPŠTINA PEĆ

SKUPŠTINA OPŠTINE PEĆ

Komitet za Politiku i Finansije

Br. Protokola: 060/01-49293

Datum: 10.07.2025

Za: Članove Komiteta za Politiku i Finansije-KPF

POZIV

Poštovani članovi/članice, pozivamo vas da čestvujete na VI sednici Komiteta za Politiku i Finansije za 2025. Godinu, koja će biti održana 17.07.2025 (u četvrtak) u 11:00 časova u Sali Komiteta za Politiku i Finansije.

Napomena: Komitet za Politiku i Finansije zadržava pravo primene člana 45 stav 3 Zakona o Lokalnoj Samoupravi, ako se to smatra potrebnim.

DNEVNI RED

1. Usvajanje dnevnog reda.
2. Razmatranje i usvajanje zapisnika sa sastanka KPF-a, od. 15.05.2025, od 18.06.2025.
3. Razmatranje i preporuka Inicijative za međunarodnu komunalnu saradnju između Opštine Peć iz Republike Kosovo i Opštine Buca iz Republike Turske.
4. Razmatranje i preporuka izveštaja o radu Gradonačelnika Opštine za prvu polovinu godine 2025. godine.
5. Razmatranje i preporuka izveštaja o prihodima i rashodima za prvu polovinu godine, januar - jun 2025. godine.
6. Razmatranje i preporuka izveštaja revizije godišnjih finansijskih izveštaja Opštine Peć za 2024. godinu i akcioni plan za nalaze revizije za 2024. godinu.
7. Razmatranje i preporuka informacija od Direktorata za kulturu i obrazovanje o završetku školske godine, testu postignuća i maturskom ispitu.
8. Pitanja i predlozi u vezi rada Opštine, istaknuti od članova, po redosledu po kome su primljeni. (Dostaviti Sekretaru ne kasnije od srede, dana 16.07.2025).

PREDSEDAVAJUĆI SKUPŠTINE
G-din Rexhep Kurtbogaj



KOMUNA E PEJËS / MUNICIPALITY OF PEJA / OPŠTINA PEĆ

KUVENDI KOMUNAL PEJË

Komiteti për Politikë e Financa

I.Numër: 060/01-30398

Pejë, datë: 15 maj 2025

PROCESVERBAL

Nga takimi i **IV-të** i Komitetit për Politikë e Financa i KK-së Pejë, mbajtur me **15 maj 2025**, në orën 11:00.

Takimi u mbajt në sallën e Komitetit për Politikë dhe Financa.

Pos anëtarëve të komitetit, në këtë takim prezantojnë: Kryesuesi z. Rexhep Kurtbogaj, drejtoresha e financave, znj.Diellza Berisha,drejtori i ÇPJ-së z.Arianit Krasniqi, Drejtori i Zhvillimit Ekonomik, z.Nasret Hajrizi, Drejtori i Bujqësisë, z.Tahir Shala, z.Luan Pavata, në cilësinë e kryesut të komisionit për tituj nderi, Udhëheqës i Sektorit të Kuvendit, z. Avni Gashi, zyrtare administrative znj. Donjeta Morina, dhe përfaqësuesit e ZIP-it.

Takimin e hapi dhe e udhëheqi, kryesuesi z. Rexhep Kurtbogaj, i cili hapi diskutimin për rendin e ditës, dhe i sqaroj të gjitha pikat të cilat janë vendosur në rend ditë.

Pas diskutimeve nga të gjithë anëtarët prezent u miratua ky rend dite, me 6 vota pro, 2 votë kundër dhe 1 votë e përmbajtur,

Rendi i Ditës

- 1.Pjesëmarrja në takim e anëtarëve të komitetit dhe mungesa.
- 2.Shqyrtimi dhe miratimi i Procesverbalit të KPF-së dt. 04.04.2025.
- 3.Shqyrtimi dhe rekomandimi për miratimin e Draft - Rregullores Nr. 02-2025 Për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores Nr. 02-2023 (KPE) për Taksa Komunale.
- 4.Shqyrtimi dhe rekomandimi për miratimin e propozim për rritjen e buxhetit të të hyrave vetanake 2024.

5.Shqyrtimi dhe rekomandimi për miratimin e bartjes së mjeteve buxhetore të pa shpenzuara nga viti 2024 në vitin 2025.

6.Shqyrtimi dhe rekomandimi i propozimit të Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme Komunale me pronën private të Euro-Steel SH.P.K, me qëllim të realizimit të interesit publik – ndërtimin e rrugës.

7.Shqyrtimi dhe rekomandimi i propozimit të Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme Komunale me pronën private të Arton (Sali) Kelmendi - me shtëpi, pronë e pronarëve Arton (Sali) Kelmendi dhe Egzana (Sejfedin) Kelmendi, me qëllim të realizimit të interesit publik - ndërtimin e objektit të ri të Administratës Komunale, përkatësisht ndërtimin e rrugës tek ura e re.

8.Shqyrtimi dhe rekomandimi i propozimit të Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme Komunale me pronën private të pronarëve Atdhe (Sali) Kelmendi dhe Rezarta (Muhamed) Kelmendi, me qëllim të realizimit të interesit publik - ndërtimin e rrugës tek ura e re.

9.Shqyrtimi dhe rekomandimi i propozimit të Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme Komunale me pronën private të pronarit Besnik Osa - shtëpi në pronësi, me qëllim të realizimit të interesit publik - rritjen e sigurisë nga vërshimet eventuale në lagjen Asllan Qeshme.

10.Shqyrtimi dhe rekomandimi i propozimit të Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme Komunale me pronën private të bashkëpronarve Luan (Dervish) Dervishaj, “Geshtenja Company” dhe Bekim (Sahit) Berisha, me qëllim të realizimit të interesit publik – ndërtimin e rrugës.

11.Shqyrtimi dhe rekomandimi i propozimit të Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme Komunale me pronën private të pronarit Luan (Dervish) Dervishaj, me qëllim të realizimit të interesit publik – ndërtimin e rrugës.

12.Shqyrtimi dhe rekomandimi i propozimit të Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme Komunale me pronën private të pronarit Luigj (Ilhami) Karagjija me shtëpi në pronësi, me qëllim të realizimit të interesit publik – ndërtimin e shtëpisë për komunitet.

13.Shqyrtimi dhe rekomandimi i propozimit të Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme Komunale me pronën private të pronarit Milaim (Azir) Ademaj, me qëllim të realizimit të interesit publik – rritjen e sigurisë nga vërshimet eventuale në lagjen Asllan Qeshme.

14.Shqyrtimi dhe rekomandimi i propozimit të Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme Komunale me pronën private të pronarit Muhamed Havolli, me qëllim të

realizimit të interesit publik – zgjerimi i rrugës.

15.Shqyrtimi dhe rekomandimi i propozimit të Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme Komunale me pronën private të bashkëpronarve Mehribane Shala me 1/3, Fatmir (Vehbi) Muhagjeri me 1/3 dhe Mazllom (Vehbi) Muhaxheri, me qellim të realizimit të interesit publik – qasje në rrugë.

16.Shqyrtimi dhe rekomandimi i propozimit të Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme Komunale me pronën private të pronarit Mustafë (Ramë) Lajçi, me qellim të realizimit të interesit publik – zgjerimi i rrugës ekzistuese.

17.Shqyrtimi dhe rekomandimi i propozimit të Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme Komunale me pronën private të Reliumd Group SH.P.K., me qellim të realizimit të interesit publik.

18.Shqyrtimi dhe rekomandimi i propozimit të Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme Komunale me pronën private të pronarit Rexhë (Avdi) Muriqi, me qellim të realizimit të interesit publik.

19.Shqyrtimi dhe rekomandimi i propozimit të Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme Komunale me pronën private të bashkëpronarëve Salih (Bekë) Lajqi me 5/12, Ali (Sadik) Abazaj me 5/12 dhe Sali (Shaban) Lajqi me 2/12, me qellim të realizimit të interesit publik – zgjerimi i rrugës.

20.Shqyrtimi dhe rekomandimi i propozimit të Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme Komunale me pronën private të pronarit Xhemë (Arif) Rexhbogaj - me shtëpi në pronësi, me qellim të realizimit të interesit publik – krijimin e hapësirës së hapur rekreative dhe gjelbërim

21.Shqyrtimi dhe rekomandimi i propozimit të Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme Komunale me pronën private të pronarit Sali (Ibrahim) Gashit, me qellim të realizimit të interesit publik.

22.Shqyrtimi dhe rekomandimi për miratimin e buxhetimit në bashkëfinancimi të Komunës së Pejës - participimi nga qytetaret (fermerët përfitues).

23.Shqyrtimi dhe rekomandimi për miratimin e Draft - Rregullores për Transparencë në Komunës së Pejës si dhe draft-plani i Veprimit për Transparencë (2025 – 2029).

24.Shqyrtimi dhe rekomandimi për miratimin e Draft Strategjisë për Zhvillimin e Turizmit - Komuna e Pejës.

25.Shqyrtimi dhe rekomandimi për miratimin për lirim nga bashkë-pagesa për Policinë e

Kosovës në kujdesin parësor shëndetësorë në Komunën e Pejës.

26.Shqyrtimi dhe rekomandimi i propozimeve të komisionit për tituj nderi, dekorata, mirënjohje dhe falënderime për vitin 2025.

27.Shqyrtimi dhe rekomandimi i informatës së progresit të adresimit të rekomandimeve të auditorit të përgjithshëm sipas planit të veprimit.

28.Shqyrtimi dhe rekomandimi i informatës tremujore financiare (janar –mars 2025) të Komunës së Pejës.

29.Shqyrtimi dhe rekomandimi i informatës mbi listën e pronave komunale dhe menaxhimin e tyre.

30.Shqyrtimi dhe rekomandimi i informatës së Drejtorisë për Administratë, mbi funksionimin e Këshillave Lokale në Komunën e Pejës.

31.Pytjet dhe propozimet lidhur me punën e Komunës, të ngritura nga anëtarët, në atë rënditje siç janë pranuar:

1.Pjesëmarrja në takim e anëtarëve të komitetit dhe mungesa.

Nuk ka pasur.

2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të KPF-së dt. 04.04.2025

Nga të gjithë anëtarët prezent me 7 votë pro, 2 anëtar nuk kanë marrë pjesë në votim, miratohet procesverbali i dt.04.04.2025.

3.Shqyrtimi dhe rekomandimi për miratimin e Draft - Rregullores Nr. 02-2025 Për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores Nr. 02-2023 (KPE) për Taksa Komunale.

Kryesusi Rexhep Kurtbogaj: ka ardhur nga drejtoria e bujqësisë është plotësim/ndryshimi i kësaj rregullore me të gjitha paragrafet, diskutimi publik është mbajtur dhe tani kemi draft rregulloren finale!

z.Tahir Shala: për ndryshim/plotësim të Rregullores për Taksa Komunale ka ndodhur një gabim teknik. Kjo ka qenë përpara për në dhënje 1 vjeçar në shfrytëzim të tokës komunale bujqësore, është një shumë simbolike 70 euro është e përcaktuar në ligj. Ka ndodhur një gabim teknik kur kemi harmonizuar herën e fundit me Bankën Botërore dhe kemi sjellë prap. Pasi kemi hyrë në këtë plotësim/ ndryshim ka qenë edhe në rregulloren e vjetër për taksa për pyje. Meqenëse në fillim vitit ka kaluar ligji për pyje krejt kompetencat i ka marrë agjensioni pyjor dhe me një rrugë i kemi sjellë dyjat me hek që më nuk është në kompetencën e ministrit.

Nga të gjithë anëtarët prezent me 5 votë pro, 4 anëtar nuk kanë mar pjesë në votim, kjo pikë i rekomandohet për shqyrtim dhe miratim në seancën e kuvendit.

4.Shqyrtimi dhe rekomandimi për miratimin e propozim për rritjen e buxhetit të të hyrave vetanake 2024.

Znj.Diellza Berisha: planifikimi i buxhetit për të hyrat vetanake në vitin 2024 ka qenë 5 milion e 365 mijë euro, ndërsa realizimi për këto të hyra ka qenë 6 milionë e 309 mijë euro. Kemi një tejkalim të planit të hyrave rreth 944 mijë dhe kjo ka ardh si pasoj e gjobave të trafikut dhe gjobat që kanë ardh nga gjykata. Ne kemi propozu që të nxiret një vendim që të hyrat vetanake për vitin 2024, të bëhet rritja buxhetore me vlerë 944 mijë dhe kjo të ndodhë në kategorit mallra dhe shërbime 26 mijë e 535 euro, në investime kapitale 918 mijë e 912 euro. Këto ndarje në këto kategori janë bërë për pagesen e obligimeve të viteve paraprake, si dhe për projektet e reja që janë në rëndësi të komunes.

Nga të gjithë anëtarët prezent me 5 votë pro, 4 anëtar nuk kanë mar pjesë në votim, kjo pikë i rekomandohet për shqyrtim dhe miratim në seancën e rregulltë të kuvendit.

5.Shqyrtimi dhe rekomandimi për miratimin e bartjes së mjeteve buxhetore të pa shpenzuara nga viti 2024 në vitin 2025.

Znj. Diellza Berisha: materialin e kemi përcjellë unë mendoj që viti 2024 sa i perket shpenzimit të buxhetit ka qenë një vitë i sukseshem. Nga të hyrat vetanake janë vetem 475 mijë e 400 euro duke e përfshirë edhe planin e tejkalimit të të hyrave 944 mijë euro. Vlen të theksohet që kemi bërë kërkesë për bartjen e këtij buxheti prej 1 milionë e 420 mijë euro dhe janë nda në tri kategori, mallra dhe shërbime, subvencionë dhe investime kapitale.

Nga të gjithë anëtarët prezent me 5 votë pro, 4 anëtar nuk kanë mar pjesë në votim, kjo pikë i rekomandohet për shqyrtim dhe miratim në seancën e rregulltë të kuvendit

6.Shqyrtimi dhe rekomandimi i propozimit të Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme Komonale me pronën private të Euro-Steel SH.P.K, me qëllim të realizimit të interesit publik – ndërtimin e rrugës.

Kryesusi Rexhep Kurtbogaj: nga pika e 6 deri tek pika 21 janë propozime që kanë ardh nga kryetari për këmbime, drejtorin e kemi prezent për sqarime.

Z.Arianit Krasniqi: vetem një përmbledhje të shkurt se pse nuk ka ardh vlersimi , për shkak se një kohe departamenti për vlersimin e pronës së paluajtshme ka qenë pa drejtor! Tani është emru një drejtoreshë por nuk kanë ardh vlersimet. Por sipas formes kanë mbet vetem vlersimet të cilat i prezentojmë në asamble, ne e kemi kontakti ministrinë dhe na kanë premtu që shumë shpejt do ti kemi vlersimet!

Nga të gjithë anëtarët prezent me 5 votë pro, 4 anëtar nuk kanë mar pjesë në votim, kjo pikë i rekomandohet për shqyrtim dhe miratim në seancën e rregulltë të kuvendit

7.Shqyrtimi dhe rekomandimi i propozimit të Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme Komunale me pronën private të Arton (Sali) Kelmendi - me shtëpi, pronë e pronarëve Arton (Sali) Kelmendi dhe Egzana (Sejfedin) Kelmendi, me qellim te realizimit të interesit publik - ndërtimin e objektit të ri të Administratës Komunale, përkatësishtë ndërtimin e rrugës tek ura e re.

Kryesusi Rexhep Kutbogaj: e hapim debatin ,nese ka dikush diqka për diskutim!

Z.Berat Ganiqi: unë po mendoj që kjo është gabim ndërtimi i objektit të ri të Administratës Komunale, përkatësishtë ndërtimin e rrugës tek ura e re

Z.Aranit Krasniqi: janë dy pjesë edhe ktu edhe aty ku pretendohet me u bo komuna, administrata në oborr të Komunes mbas Radios, e pjesa tjetër tek “Universi” meret një pjesë për ndertimine rruges.

Nga të gjithë anëtarët prezent me 5 votë pro, 4 anëtar nuk kanë mar pjesë në votim, kjo pikë i rekomandohet për shqyrtim dhe miratim në seancën e rregulltë të kuvendit

8.Shqyrtimi dhe rekomandimi i propozimit të Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme Komunale me pronën private të pronarëve Atdhe (Sali) Kelmendi dhe Rezarta (Muhamed) Kelmendi, me qellim te realizimit të interesit publik - ndërtimin e rrugës tek ura e re.

Nga të gjithë anëtarët prezent me 5 votë pro, 4 anëtar nuk kanë mar pjesë në votim, kjo pikë i rekomandohet për shqyrtim dhe miratim në seancën e rregulltë të kuvendit

9.Shqyrtimi dhe rekomandimi i propozimit të Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme Komunale me pronën private të pronarit Besnik Osa - shtëpi në pronësi, me qellim te realizimit të interesit publik - rritjen e sigurisë nga vërshimet eventuale në lagjen Asllan Qeshme.

Kryesusi Rexhep Kurtbogaj: e hapim diskutimin për anëtarët!

Nga të gjithë anëtarët prezent me 5 votë pro, 4 anëtar nuk kanë mar pjesë në votim, kjo pikë i rekomandohet për shqyrtim dhe miratim në seancën e rregulltë të kuvendit

10.Shqyrtimi dhe rekomandimi i propozimit të Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme Komunale me pronën private të bashkëpronarve Luan (Dervish) Dervishaj, “Geshtenja Company” dhe Bekim (Sahit) Berisha, me qellim të realizimit të interesit publik – ndërtimin e rrugës.

Kryesusi Rexhep Kurtbogaj: e hapim diskutimin për anëtarët!

Nga të gjithë anëtarët prezent me 5 votë pro, 4 anëtar nuk kanë mar pjesë në votim, kjo pikë i rekomandohet për shqyrtim dhe miratim në seancën e rregulltë të kuvendit

11.Shqyrtimi dhe rekomandimi i propozimit të Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme Komunale me pronën private të pronarit Luan (Dervish) Dervishaj, me qëllim të realizimit të interesit publik – ndërtimin e rrugës.

Kryesusi Rexhep Kurtbogaj: e hapim diskutimin për anëtarët!

Nga të gjithë anëtarët prezent me 5 votë pro, 4 anëtar nuk kanë mar pjesë në votim, kjo pikë i rekomandohet për shqyrtim dhe miratim në seancën e rregulltë të kuvendit

12.Shqyrtimi dhe rekomandimi i propozimit të Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme Komunale me pronën private të pronarit Luigj (Ilhami) Karagjija me shtëpi në pronësi, me qëllim të realizimit të interesit publik – ndërtimin e shtëpisë për komunitet.

Kryesusi Rexhep Kurtbogaj: e hapim diskutimin për anëtarët!

Nga të gjithë anëtarët prezent me 5 votë pro, 4 anëtar nuk kanë mar pjesë në votim, kjo pikë i rekomandohet për shqyrtim dhe miratim në seancën e rregulltë të kuvendit

13.Shqyrtimi dhe rekomandimi i propozimit të Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme Komunale me pronën private të pronarit Milaim (Azir) Ademaj, me qëllim të realizimit të interesit publik – rritjen e sigurisë nga vërshimet eventuale në lagjen Asllan Qeshme.

Kryesusi Rexhep Kurtbogaj: e hapim diskutimin për anëtarët, nese nuk ka e qesim në votim.

Nga të gjithë anëtarët prezent me 5 votë pro, 4 anëtar nuk kanë mar pjesë në votim, kjo pikë i rekomandohet për shqyrtim dhe miratim në seancën e rregulltë të kuvendit

14.Shqyrtimi dhe rekomandimi i propozimit të Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme Komunale me pronën private të pronarit Muhamed Havolli, me qëllim të realizimit të interesit publik – zgjerimi i rrugës.

Kryesusi Rexhep Kurtbogaj: e hapim diskutimin për anëtarët!

Nga të gjithë anëtarët prezent me 5 votë pro, 4 anëtar nuk kanë mar pjesë në votim, kjo pikë i rekomandohet për shqyrtim dhe miratim në seancën e rregulltë të kuvendit

15.Shqyrtimi dhe rekomandimi i propozimit të Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme Komunale me pronën private të bashkëpronarve Mehribane Shala me 1/3, Fatmir (Vehbi) Muhagjeri me 1/3 dhe Mazllom (Vehbi) Muhaxheri, me qellim të realizimit të interesit publik – qasje në rrugë.

Kryesusi Rexhep Kurtbogaj: e hapim diskutimin për anëtarët!

Nga të gjithë anëtarët prezent me 5 votë pro, 4 anëtar nuk kanë mar pjesë në votim, kjo pikë i rekomandohet për shqyrtim dhe miratim në seancën e rregulltë të kuvendit

16.Shqyrtimi dhe rekomandimi i propozimit të Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme Komunale me pronën private të pronarit Mustafë (Ramë) Lajçi, me qellim të realizimit të interesit publik – zgjerimi i rrugës ekzistuese.

Kryesusi Rexhep Kurtbogaj: e hapim diskutimin për anëtarët!

Nga të gjithë anëtarët prezent me 5 votë pro, 4 anëtar nuk kanë mar pjesë në votim, kjo pikë i rekomandohet për shqyrtim dhe miratim në seancën e rregulltë të kuvendit

17.Shqyrtimi dhe rekomandimi i propozimit të Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme Komunale me pronën private të Reliumd Group SH.P.K., me qellim të realizimit të interesit publik.

Kryesusi Rexhep Kurtbogaj: e hapim diskutimin për anëtarët!

Z.Berat Ganiqi: po e shoh që në pjesën e këmbimit është një ndërtesë që po jepet në këmbim, ndërsa po i meret në Bellopojë. Objekti tjetër përcjellëse tjera kush kanë qenë se kam të qartë?

Z.Arianit Krasniqi: është një ndërtesë që nuk e kanë lejen ndërtimore të cilën e kanë shfrytëzuar me kohë! Na kur këmbëjmë e këmbëjmë veq token e jo ndërtesën

Z.Berat Ganiqi: tash nese është ndërtesa pa leje ndërtimore, drejtorja për inspektion, drejtorja për urbanizem së bashku me juve jeni në dijeni që ka ndërtesë pa leje të ndërtume!

Z.Arianit Krasniqi: janë të ndërtuara para shumë viteve.

Nga të gjithë anëtarët prezent me 5 votë pro, 4 anëtar nuk kanë mar pjesë në votim, kjo pikë i rekomandohet për shqyrtim dhe miratim në seancën e rregulltë të kuvendit

18.Shqyrtimi dhe rekomandimi i propozimit të Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme Komunale me pronën private të pronarit Rexhë (Avdi) Muriqi, me qellim të realizimit të interesit publik.

Kryesusi Rexhep Kurtbogaj: e hapim diskutimin për anëtarët!

Nga të gjithë anëtarët prezent me 5 votë pro, 4 anëtar nuk kanë mar pjesë në votim, kjo pikë i rekomandohet për shqyrtim dhe miratim në seancën e rregulltë të kuvendit

19.Shqyrtimi dhe rekomandimi i propozimit të Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme Komunale me pronën private të bashkëpronarëve Salih (Bekë) Lajqi me 5/12, Ali (Sadik) Abazaj me 5/12 dhe Sali (Shaban) Lajqi me 2/12, me qëllim të realizimit të interesit publik – zgjerimi i rrugës.

Kryesusi Rexhep Kurtbogaj: e hapim diskutimin për anëtarët!

Nga të gjithë anëtarët prezent me 5 votë pro, 4 anëtar nuk kanë mar pjesë në votim, kjo pikë i rekomandohet për shqyrtim dhe miratim në seancën e rregulltë të kuvendit

20.Shqyrtimi dhe rekomandimi i propozimit të Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme Komunale me pronën private të pronarit Xhemë (Arif) Rexhbogaj - me shtëpi në pronësi, me qëllim të realizimit të interesit publik – krijimin e hapësirës së hapur rekreative dhe gjelbërim

Kryesusi Rexhep Kurtbogaj: e hapim diskutimin për anëtarët!

Nga të gjithë anëtarët prezent me 5 votë pro, 4 anëtar nuk kanë mar pjesë në votim, kjo pikë i rekomandohet për shqyrtim dhe miratim në seancën e rregulltë të kuvendit

21.Shqyrtimi dhe rekomandimi i propozimit të Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme Komunale me pronën private të pronarit Sali (Ibrahim) Gashit, me qëllim të realizimit të interesit publik.

Kryesusi Rexhep Kurtbogaj: e hapim diskutimin për anëtarët!

Nga të gjithë anëtarët prezent me 5 votë pro, 4 anëtar nuk kanë mar pjesë në votim, kjo pikë i rekomandohet për shqyrtim dhe miratim në seancën e rregulltë të kuvendit

22.Shqyrtimi dhe rekomandimi për miratimin e buxhetimit në bashkëfinancimi të Komunës së Pejës - participimi nga qytetarët (fermerët përfitues).

Kryesusi Rexhep Kurtbogaj: kjo pikë është rekomandim nga drejtoria e bujqësisë për fermeret përfitues, drejtori është prezent nese keni ndonjë paqartësi!

Znj.Zize Hakaj Veselaj: këto subvencione a po ndahen me merit a kujt po doni ju të LDK-së?

Z.Tahir Shala: a keni nevoj për ndonjë sqarim shtesë?

Kryesusi Rexhep Kurtbogaj: nese nuk ka diqka për diskutim e qesim në votim!

Nga të gjithë anëtarët prezent me 5 votë pro, 4 anëtar nuk kanë mar pjesë në votim, kjo pikë i rekomandohet për shqyrtim dhe miratim në seancën e rregulltë të kuvendit

23.Shqyrtimi dhe rekomandimi për miratimin e Draft - Rregullores për Transparencë në Komunës së Pejës si dhe draft-plani i Veprimit për Transparencë (2025 – 2029).

Kryesusi Rexhep Kurtbogaj: rregulorja për trasparencë ka qenë edhe në diskutim publik tani e kemi edhe draftin final , nese ka dikush diqka për diskutim po e propozojmë për kuvend

Nga të gjithë anëtarët prezent me 5 votë pro, 4 anëtar nuk kanë mar pjesë në votim, kjo pikë i rekomandohet për shqyrtim dhe miratim në seancën e rregulltë të kuvendit

24.Shqyrtimi dhe rekomandimi për miratimin e Draft Strategjisë për Zhvillimin e Turizmit - Komuna e Pejës.

Z.Nasret Hajrizaj: unë mendoj që është përpilu një dokument i mirë për kohën e caktuar. Në të parashihen edhe procedurat edhe investimet kapitale edhe shumë gjëra të tjera. Është një dokument që e kemi përpilu ne drejtoria për zhvillimin e turizmit së bashku me Swiss Kontakt që na ka ndihmu, dhe ka pas edhe diskutimi publike edhe takime me ekspert të ndryshem dhe kemi ardh deri te ky përfundim që mendoj që është një rrugë e mirë.

Nga të gjithë anëtarët prezent me 7 votë pro, 2 anëtar nuk kanë mar pjesë në votim, kjo pikë i rekomandohet për shqyrtim dhe miratim në seancën e rregulltë të kuvendit.

25.Shqyrtimi dhe rekomandimi për miratimin për lirim nga bashkë-pagesa për Policinë e Kosovës në kujdesin parësor shëndetësore në Komunën e Pejës.

Znj.Zize Hakaj Veselaj: incitiv e mirë koka por unë që 22 vite qe punoj policia nuk ka pagu asnjehere tek unë në ambullant dhe shumë mirë që tash koka bë e ligjeshme.

Z.Labinot Panxha: meqenëse nuk është drejtori prezent nuk ish dasht me diskutu fare ketë pikë e kemi bë si rregullë na mos me diskutu për ta fare për ata që nuk janë prezent! Por i kam pas shumë kërkesa nga veteranët të kategorive të luftes që kur kanë marr trajtim mjeksorë në QKMF kanë paguar. Ata i lejon ligji për kategorit e dalur nga lufta por për qudi ata kanë pagu. Po ashtu edhe pagesa të cilën e kanë prezentuar nuk ka qenë fletëpagese por ka qenë një fletë e bardh e zakonshme j'a kanë shkru çmimin dhe janë detyru me pagu. Sa i perket policëve shumë mirë që lirohen nga pagesa edhe ata i kanë pagat e vogla dhe shumë mirë që lirohen prej ketyre pagesave. Mirpo fillimishtë ish dasht me u kujdesë dhe me rregullu ketë çështjen e veteranëve të luftes sespe duke j'u marr atyre pare për sherbime janë duke e bër një shkeleje të ligjit për kategorit e ndara nga lufta të cilët i liron. Po ashtu çështja e dytë për qytetarët ë vin nga Lugu i Baranit në një Qender Mjeksore në Pejë, të cilet nuk kanë udhëzim sepse ambullanta mbyllet në

oren dymbëdhjetë ai nuk mundet me marr udhëzimin me u kontrollu në Pejë. Këto çështje janë shumë të nëvojshme me u rregullu.

Znj.Drita Maloku: unë që një vitë jam larguar por për sqarim kjo nuk është detyrim nga komuna por na ka ardh nga ministria. Obligative është dhe e kanë bo për regjionalizim që secili pacient me u kontrollu në regjionin e vet, përndryshe nese e ndrron regjionin ka me bo pagesë.

Znj.Zize Hakaj Veselaj: po po është nga ministria mirpo veteranëve nuk duhet me ju bo pagese, duhet me qen të liruar.

Znj.Kaltrina Lajqi: unë vetem kisha dasht me dëshmu të kundërten e asaj që tha Labi, unë jam vajza e veteranit dhe asnjehere nuk kam pagu as unë dhe as familja ime. Mjafton vetem me pas karten ose me dit nr e karteles veteranit dhe je i liruar nga pagesa.

Z.Labinot Panxha: për hir të korektësisë nese me ke kuptu thash në momentin që nuk ka udhëzim e detyrojnë me pagu 5 euro, jo kur shkon prej ores 07:00-15:00, por kur shkon prej ores 15:00 kur mbyllet ambulanta në Baran, ai veteran ska ku me mar udhëzimin dhe kuir vjen ne Raushiq dr.Zizë i thotë me pagu 5 euro unë këtë e thash!

Kryesusi Rexhep Kurtbogaj: ju si anëtar i kuvendit mundeni me shtjellu këtë çështje dhe në seancë të kuvendit me drejtorinë e shendetësis dhe me diskutu këtë çështje

Znj.Drita Maloku: znj. Zizë, cekeni që një kohë nuk keni pas deftesa

Znj.Zize Hakaj Veselaj: me rendësi është e lëshume Drite dhe tregon që i ka pagu 5 euro.

Nga të gjithë anëtalet prezent me 8 votë pro, 1 anëtar nuk kanë mar pjesë në votim, kjo pikë i rekomandohet për shqyrtim dhe miratim në seancën e rregulltë të kuvendit

26.Shqyrtimi dhe rekomandimi i propozimeve të komisionit për tituj nderi, dekorata, mirënjohje dhe falënderime për vitin 2025.

Kryesusi Rexhep Kurtbogaj: i kemi mar nga drejtoria e DKRS-së informatat nga takimet e mbajtura me komisionit të zgjedhur nga kuvendi komunal për tituj nderi, mirënjohje dhe falenderime. Anëtalet e këtij komisioni janë: Xhenet Syka Kelmendi, Mubera Belegu, Fatime Shala, Luan Pavata dhe Teuta Uka. Fillimishtë kanë ardh propozimet që i kanë shqyrtu pastaj në procesverbalin e dytë kanë ardh keta emra të propozuar dhe të miratuar nga komisioni. Drejtoreshen nuk e kemi prezent për shkak të një angazhimi tjetër por e kemi prezent Luan Pavata që ka qenë kryesusi i komisionit.

Z.Berat Ganiqi: mas parti emrat nuk i kemi të shënuara në procesverbal dhe se dim as kush janë, ndërsa e dyta për antaren e kuvendit e cila ka reagu edhe me email nuk është dakordu për emrat. Mirë kishte me qenë me i pa emrat dhe kontributet te cilat i kanë në procesverbal, se kjo është pikë e rendit dites e jo me pika të shkurta dhe nuk po dihet kurgjo, takimet e di që janë mbajtur po emra ketu nuk ka askund!

Kryesusi Rexhep Kurtbogaj: janë shkruar emrat në procesverbal dhe unë sot po i lexoj.

1. Titulli “Qytetar Nderi” - Timo Flloko,
2. Titulli “Qytetar Nderi” - Halil Kastrati,
3. Titulli “Qytetar Nderi” - Zija Mulhaxha,
4. Titulli “Qytetar Nderi” - Rosaria Succurro,
5. Titulli “Qytetar Nderi” - Ukë Hysen Nimani,
6. Titulli “Qytetar Nderi” - Post Mortum - Xhevdet Ademaj,
7. Titulli “Qytetar Nderi” - Post Mortum - Dervish Avdijaj,
8. Titulli “Nderi i Qytetit” - Ramiz Kelmendi,
9. Titulli “Nderi i Qytetit” - Ekrem Lluka,
10. Titulli “Nderi i Qytetit” - Blerim Devolli,
11. Titulli “Nderi i Qytetit” - Shkelqim Devolli,
12. Titulli “Lekë Dukagjini” - Gëzim Muriqi,
13. Titulli “Azem Shkreli” - Post Mortum - Sylë Osmanaj,
14. Titulli “Mirënjohje” - Shoqata e Sportit,
15. Titulli “Mirënjohje” - SHBA “Gjeravica”,
16. Titulli “Mirënjohje” - Vehbi Shala,
17. Titulli “Mirënjohje” - Mevlyde Pupovci.

Z.Berat Ganiqi: më mirë ketë “ Nderi i Qytetit” me bo “ Nderi i Pushtetit Lokal” ju ka ndihmu në zgjedhje dhe kështu i shpërbleni. Me gjithë respektin, kjo është kthim i shpërblimit të kontributit të zgjedhjeve e tash janë zgjedhjet lokale. Nese ish bo vjet ose parvjet nuk kishte me qenë ndonjë ndryim , bo biznismenat me i shti në ketë vjet si “Nderi i Qytetit ” kjo tregon sa është i fuqishëm kryetari.

Z.Luan Pavata: deshta të flas për anëtarin e VV-së që në takim asnjë fjalë nuk e ka fol dhe nuk ka qenë kundër për kurgjo, pastaj kur ka bisedu me partin e saj tash është kundër!

Znj.Hidajete Nikçi: Luan, a ka votu kundër?

Z.Luan Pavata: nuk ka pas me votu vetem a jeni dakord të gjithë po shumë mirë, nuk kena ngritë gishta!

Z. Berat Ganiqi: vetem edhe diqka në mbledhjet dhe me referencat me mu drejtu ky kështu nuk e toleroj, jemi subjekt politik dhe nese vazhdon qështu na nuk marim pjesë as në seancë solemne. Me gjithë respektin për Timo Flloku e kta tjerët, dhe më vjen keq për herë të parë si opozitë që jemi, nuk marim pjesë në disa vlersime që janë më shumë larje e hesapeve dhe kthimit të borgjeve.

Nga të gjithë anëtarët prezent me 5 votë pro, 1 anëtar nuk kanë mar pjesë në votim, kjo pikë i rekomandohet

27.Shqyrtimi dhe rekomandimi i informatës së progresit të adresimit të rekomandimeve të auditorit të përgjithshëm sipas planit të veprimit.

Kryesusi Rexhep Kurtbogaj: materialin e keni marr , drejtoresha është prezent nese ka dikush diqka për diskutim.

Znj.Diellza Berisha: materialin që e kanë marr është i vitit 2023 sepse për vitin 2024 akoma nuk kemi pranuar raport të auditorit. Auditorët i kemi pas kësaj dhe i kanë marr materialet që i kanë kërkuar dhe nuk e di për çfarë arsye është vonuar! Derisa të kemi një raport të auditorit për vitin 2024, nuk mundemi me nxirr një plan të progresit.

Kryesusi Rexhep Kurtbogaj: në plan të punës së kuvendit e kemi si pikë që duhet me diskutu.

Nga të gjithë anëtarët prezent me 8 votë pro, 1 anëtar nuk kanë marr pjesë në votim, kjo pikë i rekomandohet kuvendit informatë e progresit të adresimit të rekomandimeve të auditorit të përgjithshëm sipas planit të veprimit.

Kryesusi Rexhep Kurtbogaj: për koleget e mi të opozites e kam një pyetje, pikat që i kemi këtu shumica e pikave që i kemi në planin e punës së kuvendit, qëllimi i tyre është një lloj obligimi ndaj ekzekutivit. Që duhet me na paraqit neve raportet informative, informatat që ta obligohen ndaj neve. Kjo pikë është pjesë e planit të punës së kuvendit, realishtë si pikë është që ndikon në transparencë dhe në informatë të qytetarëve në diskutimet që i bëjmë në seancën e kuvendit. Po çuditërisht pse nuk votohet kjo pikë, sepse nuk i shkon aspak në favor qeverisjes komunale, ekzekutivit nese nuk del në shqyrtim. Kjo është pjesë që si pozitë si opozitë e kërkojmë me u diskutu në seancë të kuvendit, po i shoh anëtarët e opozites që spo e votojnë, por realishtë është më mirë me votu.

Z.Labinot Panxha: unë, mendoj që si informatë nuk duhet me u hedh as në votim. Thjeshtë është një informatë që nuk e lyp të drejtën e votimit. Ne kemi drejtë me votu pro, kundër me abstenu. Nuk na obligon kurgjo për me votu ose mos me votu. Përveq kësaj na nuk marrim pjesë në votim për arsye sepse shumë here të kam tregu, pasi që vota jonë është e pavlerë. Kemi pas shumë rast dhe ju vet keni qenë pjesë e një vote kundër që e kemi dhënë edhe na dhe 3 kanë qenë pro nga pozita dhe megjithatë ajo pikë ju ka rekonadur kuvendit. Është e vërtetë që ashtu thotë një rregullore mirpo e kanë aprovu në kuvend pa e shqyrtu mirë, dikush nuk e ka dërgu në MAPL ligjëshmërinë e saj. A shkelet ndonjë e drejtë qoftë kushtetuese apo ligjet tjera që e përaktojnë mënyrën e votimit. Në parim ti ke drejtë kur më thush mua që rregulloja e përcakton pavarësishtë se a i mer votat apo nuk i mer votat ajo i rekomandohet kuvendit. Cila është vlera e votes time ose e të tjerëve nese na jemi 7 kundër dhe ajo prap se prap i rekomandohet kuvendit?

Kryesusi Rexhep Kurtbogaj:jemi në rregull por pyetje ke tjetër sepse kjo pikë është e planit të punës së kuvendit dhe ne e bëjmë bashkërishtë dhe kemi pika që i qesim brenda planit të punës. Ne e kemi votu njëherë që këtë pikë me qit në plan dhe ne si kuvend e obligojnë ekzekutivin që me na sjellë këtë informatë.

28.Shqyrtimi dhe rekomandimi i informatës tremujore financiare (janar –mars 2025) të Komunës së Pejës.

Znj. Diellza Berisha: materialin e keni mar të detajuar dhe nuk kam qka me cekë jashta ketij materialit. Vetem deshta me cekë që të hyrat pak kanë ra dhe ka ndiku këtu rregulloja taksat dhe tarifat, ku një pjesë të hyrave janë liru. Pataj tek pjesa e administres ka ndiku edhe platforma E-Kosova ku tash certifikatat meren përmes platformes online. Pak të hyra ka rritje në bujqësisë edhe tek pjesa e buxhetit, pjesa e tatimit në pronë. Sa i përket shpenzimit të buxhetit tek investimet kapitale kemi rritje në krahasim me periudhen 3 mujorshe në vitin e kaluar. Kjo rritje e shpenzimeve ka ndiku për shkak se një pjesë e punimeve është duke u zhvillu. Deri me tani kemi 27% të realizimit të buxhetit tek investimet kapitale, 24.81% tek mallra dhe shërbime. Kjo vetem një përmbledhje e shkurt në pika të shkurta në sennë të kuvendit mundem me i diskutu të gjitha.

Nga të gjithë anëtarët prezent me 5 votë pro, 3 anëtar nuk kanë mar pjesë në votim, kjo pikë i rekomandohet kuvendit informatë tremujore financiare.

29.Shqyrtimi dhe rekomandimi i informatës mbi listën e pronave komunale dhe menaxhimin e tyre.

Kryesusi Rexhep Kurtbogaj: është një pikë e planit të punës së kuvendit, nese nuk ka dikush diqka për diskutim e qesim në votim.

Nga të gjithë anëtarët prezent me 5 votë pro, 4 anëtar nuk kanë mar pjesë në votim, kjo pikë i rekomandohet kuvendit informatë mbi listën e pronave komunale dhe menaxhimin e tyre.

30.Shqyrtimi dhe rekomandimi i informatës së Drejtorisë për Administratë, mbi funksionimin e Këshillave Lokale në Komunën e Pejës.

Kryesusi Rexhep Kurtbogaj: është një raport që e sjellë drejtorja për administratë, materialin e ka dërgu si informatë rreth funksionimit të Këshillave Lokal. Preznet nuke kemi kërkënd nga administrata, meqenëse ka pas me qenë prezent kordinatori që është i caktuar!

Nga të gjithë anëtarët prezent me 5 votë pro, 4 anëtar nuk kanë mar pjesë në votim, kjo pikë i rekomandohet kuvendit informatë e Drejtorisë për Administratë, mbi funksionimin e Këshillave Lokale në Komunën e Pejës

31.Pytjet dhe propozimet lidhur me punën e Komunës, të ngritura nga anëtarët, në atë rënditje siç jan pranuar:

Nuk ka pasur

Pjesë e këtij procesverbali është edhe audio incizimi i këtij takimi të Komitetit për Politikë dhe Financa.

Meqë u shqyrtuan të gjitha pikat e rendit të ditës e propozime të tjera nuk pat, kryesuesi z. Rexhep Kurtbogaj e shpalli të mbyllur këtë takim të KPF-së në orën 12:10 h.

**Procesmbajtësja,
znj. Donjeta Morina**

**K R Y E S U E S I,
z. Rexhep Kurtbogaj**



KUVENDI KOMUNAL PEJË

Komiteti për Politikë e Financa

I.Numër: 060/01-41432

Pejë, datë: 18.06.2025

PROCESVERBAL

Nga takimi i V-të i Komitetit për Politikë e Financa i KK-së Pejë, mbajtur me **18 qershor 2025**, në orën 09:00.

Takimi u mbajt në sallën e Komitetit për Politikë dhe Financa.

Pos anëtarëve të komitetit, në këtë takim prezantojnë: Kryesuesi z. Rexhep Kurtbogaj, Udhëheqës i Sektorit të Kuvendit, z. Avni Gashi, zyrtare administrative znj. Donjeta Morina, dhe përfaqësuesit e OSCE-së dhe ZIP-it

Takimin e hapi dhe e udhëheqi, kryesuesi z. Rexhep Kurtbogaj, i cili hapi diskutimin për rendin e ditës, dhe i sqaroi të gjitha pikat të cilat janë vendosur në rend ditë dhe deklaroi që pika e 2.Procesverbali i KPF-së dt.15.05.2025, tërhiqet nga rendi i ditës.

Unanimishtë nga gjithë anëtarët prezent u miratua ky rend dite,

Rendi i Ditës

1. Aprovimi i rendit të ditës.
2. Shqyrtimi dhe rekomandimi për aprovimin e Kornizës Afatmesme Buxhetore 2026-2028.
3. Shqyrtimi dhe rekomandimi për themelimin e grupit punues për hartimin e planit të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2026.
4. Shqyrtimi dhe rekomandimi për miratimin e Planit Ndërkomunal për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave (PNMIM) 2025-2035.
5. Shqyrtimi dhe rekomandimi i raportit (informatës) mbi zhvillimin ekonomik dhe turizmin në Komunën e Pejës.
6. Shqyrtimi dhe rekomandimi i raportit (informatës) rreth aktiviteteve të KKSB-së.
7. Pytjet dhe propozimet lidhur me punën e Komunës, të ngritura nga anëtarët, në atë rënditje siç janë pranuar

1.Pjesëmarrja në takim e anëtarëve të komitetit dhe mungesa.

Nuk ka pasur.

2.Shqyrtimi dhe rekomandimi për aprovimin e Kornizës Afatmesme Buxhetore 2026-2028.

Kryesusi Rexhep Kurtbogaj: e kemi dërgu qarrkoren e parë buxhetore, ashtu siq ka ardh nga ministria tek ju. Sot, ju kemi dërgu edhe një raport prej diskutimit publik që është mbajtur për Kornizen Afatmesme Buxhetore, ndërsa drejtorja e financave obligohet që të sjellë materialin përfundimtar, deri me tani nuk ka ardh!

Z.Labinot Panxha: unë po e shoh këtu po e shoh një emer bashkësia lokale Anton Çeta kush është? Vazhdimi i kanaleve të ujitjetje për 40m rregullimi i varrezave në Gllogjan dhe Kosuriq. Nuk e di a është mbajtur dëgjimi buxhetore në këtë bashkësi, mirpo janë me 10-tra punë që ish dasht me i cekë e me u krye kto punë në fshatrat e bashkësisë Gllogjan e nuk është vetëm rregullimi i varezave sespe për nga një muri ato nuk prishen. Por ka mungesë të trotuareve, ujit të pijshem, mungesë të kanalizimeve të ujërave të zeza, mungesë kanaleve të ujitjes, mungesë ndriqimit publik, rregullimit të shtretërve të lumejve në ato fshatra etj etj. Po besoj që kërkesat që i ka paraqit ky person janë shumë e më shumë që ish dasht me i përfshi në këtë kornizë afatmesme buxhetore. Me aq sa o shoh këtu dhe qe sa vite në qeverisje lokale LDK- nuk pasaka arrit me rregullu infrastukturen, sepse të gjitha kërkesat e bashkësive lokale janë rregullimi dhe

ndërtimi i rrugëve në këto fshatra. Unë, po besoj dhe po shpresoj që marr një përgjigje se a ka pas dëgjim buxhetore në bashkësinë teritoriale në Gllogjan?

Kryesusi Rexhep Kurtbogaj: në dëgjim ka qenë Anton Antoni i cili i ka bërë këto kërkesa, por paska ndodh një gabim teknik në emër. Ndërsa dëgjimet buxhetore për projekte dhe ndërtimi kanë me qenë pas qarrkores së dytë për projekte dhe ndërtime. Në muajin korrik ndahen bashkësit për diskutime publike.

Nga të gjithë anëtarët prezent me 5 votë pro, 4 anëtar nuk kanë marr pjesë në votim, i rekomandohet kuvendit për shqyrtim dhe aprovimin e Kornizës Afatmesme Buxhetore 2026-2028.

3.Shqyrtimi dhe rekomandimi për themelimin e grupit punues për hartimin e planit të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2026.

Kryesusi Rexhep Kurtbogaj: si çdo vit që e bëjmë themelimin e grupit punues për hartimin e planit kuvendit të komunës për vitin 2026, dërgohet edhe sygjërimi te ekzekutivit qoftë për rregullore të ndryshe apo për raporte informative. Grupi punues përbëhet prej shtatë anëtarëve nga subjektet politike, sekretaria e kuvendit dhe shoqëria civile.

Z.Labinot Panxha: në lidhje me formimin e grupit a e ka parapa dikush që nese propozohen emrat e anëtarëve të kuvendit që janë tash aktualishtë asambleistë në vitin 2026 a kanë me qenë, a kanë me u zëvendësuar? A po do të formohet një grup punës formalishtë? A po ndodhshta ky grup ish dasht me u formu në 2026-en?

Kryesusi Rexhep Kurtbogaj: ne e kryjmë punën si grup punues dhe e lëjmë të gatshe Draftin pastaj nese miratohet ose jo!

Z.Labinot Panxha: realishtë të gjitha qka i propozon munden mos me kalu, çka tani?

Znj.Zize Hakaj Veselaj: kanë me i caktu do që kalojnë

Z.Avni Gashi: vitin e kaluar e kemi miratu në muajin shtator

Kryesusi Rexhep Kurtbogaj: nuk ka lidhje nese e miratojnë anëtarët e këtij mandati, nuk ka asgjë problem

Z.Labinot Panxha: spo di a jemi të qartë, a jemi na qe ky grupi punues që e ka hartu planin e punës së kuvendit për vitin 2026?

Z.Avni Gashi: është grupi punues që ka me u themelu tash për vitin 2026.

Unanimishtë nga të gjithë anëtarët i rekomandohet kuvendit për shqyrtim dhe miratim për themelimin e grupit punues për hartimin e planit të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2026

4.Shqyrtimi dhe rekomandimi për miratimin e Planit Ndërkomunal për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave (PNMIM) 2025-2035.

Kryesusi Rexhep Kurtbogaj: ne e kemi marrë një material që ka të bëjë me këtë plan dhe ne e kemi sjellë në shqyrtim sipas konkluzionit që na ka ardhë në KPF . Mirpo drejtorja është e obliguar të mbajë edhe një diskutim publik për këtë plan, nese e mbajnë diskutimin deri në periudhën para seancës mundemi me qit për shqyrtim në seancën e rregulltë në fund të muajit. Nese nuk mbahet diskutimi publik atëherë këtë pikë duhet me lënë për tjetër herë sepse është obligative me dalë në diskutim publik.

Nga të gjithë anëtarët prezent me 5 votë pro, 4 anëtar nuk kanë marrë pjesë në votim, i rekomandohet kuvendit për shqyrtim dhe aprovimin e Planit Ndërkomunal për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave (PNMIM) 2025-2035.

5.Shqyrtimi dhe rekomandimi i raportit (informatës) mbi zhvillimin ekonomik dhe turizmin në Komunën e Pejës.

Kryesusi Rexhep Kurtbogaj: nuk na kanë sjellë material si informatë mbi zhvillim dhe turizem. Muajin e kaluar e kemi miratuar strategjinë e turizmit nga DZHE.Sipas planit të punës e kanë obligim me na paraqitë informatën për zhvillim dhe turizem.

Nga të gjithë anëtarët prezent me 5 votë pro, 4 anëtar nuk kanë marrë pjesë në votim, i rekomandohet kuvendit për shqyrtim informatë mbi zhvillimin ekonomik dhe turizmin në Komunën e Pejës.

6.Shqyrtimi dhe rekomandimi i raportit (informatës) rreth aktiviteteve të KKSB-së.

Kryesusi Rexhep Kurtbogaj: materialin nuk e kanë sjellë ende mirpona ka ardhë si konkluzion për me qitë në rend dite në KPF. Takimet i kanë të rregullta KKSB-ja dhe për seancë të rregulltë besoj që na sjellin edhe raportin rreth aktiviteteve.

Nga të gjithë anëtarët prezent me 5 votë pro, 4 anëtar nuk kanë marrë pjesë në votim, i rekomandohet kuvendit për shqyrtim raporti (informatës) rreth aktiviteteve të KKSB-së.

7.Pytjet dhe propozimet lidhur me punën e Komunës, të ngritura nga anëtarët, në atë rënditje siç janë pranuar:

Z.Berat Ganiqi: po e shoh shqetësuese votimi që po bëhet, kjo është sikur diqka ka me ndodhë nesër dhe nuk dimë se çka ka me ndodhë! Praktik e keqe është bërë nga drejtoritë me votu diqka që as nuk kemi material dhe as nuk e kemi pa, dhe po mendoj që ka kalu në një nivel tjetër profesionalizmi me votu diqka çka nuk shihet!

Z.Mentor Bajri: nese secilen pikë nuk e shqyrtojmë e me votu athere nuk kishim me pas kuvend fare!

Z.Labinot Panxha: bash për këtë e kemi pas një bisedë me kryesusiin për një rregullore që ka kalu në kuvend kur thotë që edhe nese nuik e marrim numrine mjaftushem të votave të komitetit, athëhere i rekomandohet kuvendit, gjë që për mua është shumë gabim.

Pjesë e këtij procesverbali është edhe audio incizimi i këtij takimi të Komitetit për Politikë dhe Financa.

Meqë u shqyrtuan të gjitha pikat e rendit të ditës e propozime të tjera nuk pat, kryesuesi z. Rexhep Kurtbogaj e shpalli të mbyllur këtë takim të KPF-së në orën 12:10 h.

**Procesmbajtësja,
znj. Donjeta Morina**

**K R Y E S U E S I,
z. Rexhep Kurtbogaj**

22.04.2025

REPUBLIKA E KOSOVËS



Komuna e Pejës

REPUBLIKA E TURKIJES



Komuna e Buca

PROTOKOL BËNJAKEZIMI MES DY KOMUNA

Komuna e Pejës, Republika e Kosovës, Komuna e Buca, Republika e Turqisë (në tekstin e mëtejshme "palë") më 22.04.2025 kanë nënshkruar një Protokoll për mirëkuptim të ndërsjellë dhe synim për binjakëzimin bazuar në marrëdhëniet miqësore të zhvilluara ndërmjet këtyre dy komunave. Palët e këtij Protokollit kanë rënë dakord të bashkëpunojnë në fushat e mëposhtme:

- Zhvillimi dhe thellimi i marrëdhënieve dypalëshe ndërmjet dy komunave në kuadër të akteve ligjore në fuqi të dy vendeve.
- Rritja e mundësive për bashkëpunim ekonomik mes dy komunave
- Pjesëmarrja në aktivitete kulturore ndërkombëtare
- Zhvillimi i programeve të shkëmbimit të të rinjve ndërmjet dy bashkive

Palët e këtij Protokollit do të caktojnë nga një koordinator nga secila palë, me qëllim rritjen e efikasitetit të mirëkuptimit dhe bashkëpunimit të ndërsjellë ndërmjet dy komunave.

Ky Protokoll do të rinovohet çdo 5 (pesë) vjet me shqyrtim të ndërsjellë të nevojave të të dyja komunave.

Protokollit është përgatitur në 6 (gjashtë) kopje, nga të cilat 2 (dy) në gjuhën shqipe, 2 (dy) në anglisht dhe 2 (dy) në gjuhën turke.

Ky Protokoll do të hyjë në fuqi në datën e nënshkrimit të tij nga të dyja palët.

Republika e Turqisë
Komuna e Buca

Kryetar Bashkie
Arkitekt Görkem DUMAN

Republika e Kosovës
Komuna e Pejës

Kryetar Bashkie
Gazmend MUHAXHERI

22.04.2025

KOSOVA CUMHURİYETİ



İpek Belediyesi

TÜRKİYE CUMHURİYETİ



Buca Belediyesi

KARDEŞ ŞEHİR PROTOKOLÜ

Peja Belediyesi, Kosova Cumhuriyeti Buca, İzmir Şehri, Türkiye Belediyesi (bundan sonra “ taraflar” olarak anılacaktır) 22.04.2025 tarihinde bu iki belediye arasında geliştirilen dostane ilişkilere dayalı olarak bir karşılıklı anlayış ve kardeş şehir olma niyeti Protokolü imzalamıştır. Bu Protokolün tarafları aşağıdaki alanlarda işbirliği yapmayı kabul etmişlerdir:

- İki ülkenin yürürlükteki yasal düzenlemeleri çerçevesinde iki belediye arasındaki ikili ilişkilerin geliştirilmesi ve derinleştirilmesi
- İki belediye arasındaki ekonomik işbirliği olanaklarının artırılması
- Uluslararası kültürel faaliyetlere katılım
- İki belediye arasında gençlik değişim programlarının geliştirilmesi

Bu Protokolün tarafları, iki belediye arasındaki karşılıklı anlayış ve işbirliğinin verimliliğini artırmak amacıyla her iki tarafa bir koordinatör atayacaktır.

Bu Protokol, her iki belediyenin ihtiyaçlarının karşılıklı olarak dikkate alınmasıyla her 5 (beş) yılda bir yenilenecektir.

Protokol, 2 (iki) Arnavutça, 2 (iki) Türkçe ve 2 (iki) İngilizce olmak üzere 6 (altı) nüsha halinde hazırlanmıştır.

Bu Protokol, her iki tarafça imzalandığı tarihte yürürlüğe girecektir.

Türkiye Cumhuriyeti
Buca Belediyesi
Belediye Başkanı

Mimar Görkem Duman

Kosova Cumhuriyeti
İpek Belediyesi
Belediye Başkanı

Gazimend Muhaxheri



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E PEJËS / MUNICIPALITY OF PEJA / OPŠTINA PEĆ

Drejtoria Komunale e Arsimit

DATË/A:	09.07.2025
REFERENC-Ë:	552/29
PËR/ZA/TO:	Kryesuesin e kuvendit Z.Rexhep Kurtbogaj, sekretarin Z.Avni Gashin dhe Kastriot Belegun
NGA/OD/FROM: DKA	Drejtoria Komunale e Arsimit-Peje
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Raport për rezultatet e testit të Arritshmërisë 2025 në nivel komune

Rezultati i testit të Arritshmërisë 2025 në nivel komune sipas lëndëve

Nr.	Kodi i shkollës	Shkolla	Gjuhë shqipe	Gjuhë angleze	Histori	Gjeografi	Matematike	Informatikë	Fizike	Kimi	Biologji	Total	%	nr.nx
1	11	Hilë Mosi	310	50	222	191	277	75	100	89	125	1439	65.41	22
2	12	Lidhja e Pejës	512	79	362	301	388	125	147	146	198	2258	56.45	40
3	7	Asdreni	1209	203	759	636	850	282	328	350	426	5043	56.03	90
4	28	Zef Serembe	130	16	75	58	65	34	40	32	35	485	53.89	9
5	19	Ramiz Sadiku	908	167	588	482	534	233	238	243	320	3713	53.81	69
6	3	7 Shtatori	638	111	448	418	419	154	193	175	270	2826	52.33	54
7	8	Dardania	1169	193	711	568	647	254	319	300	318	4479	52.08	86
8	21	Rilindja	394	63	279	228	234	107	128	122	126	1681	50.94	33
9	1	Cambridge School	227	41	145	117	140	44	58	60	83	915	50.83	18
10	6	Ali Kelmendi	272	52	207	178	182	66	78	71	110	1216	50.67	24
11	13	Lidhja Prizrenit	1237	229	832	711	849	313	336	314	374	5195	49.95	104
12	5	Tetë Marsi	1576	261	1018	849	1008	350	435	370	394	6261	49.7	126
13	4	28 Nentori	438	76	285	212	273	97	114	102	143	1740	48.33	36
14	25	Vaso Pasha Shkodran	431	75	281	238	256	101	98	104	146	1730	48.06	36
15	27	Xhemajl Kada	1214	195	753	658	798	263	315	229	354	4779	47.8	100
16	24	Smajl Hajdaraj	448	60	294	191	267	93	103	88	136	1680	46.67	36
17	22	Sami Frashëri	180	30	140	92	122	41	48	33	49	735	45.94	16
18	10	Haxhi Zeka	322	59	219	147	198	75	87	82	120	1309	45.14	29
19	18	Pjeter Budi	151	21	107	89	103	38	50	59	56	674	44.93	15
20	14	Mehmet Shoshi	177	36	113	80	127	43	61	47	57	741	43.59	17
21	26	Dëshmoret e Kombit	304	47	218	130	174	75	86	96	90	1220	43.57	28
22	2	2 Korriku	267	36	175	109	134	48	73	65	79	986	42.87	23
23	15	Migjeni	179	31	86	83	62	34	40	59	65	639	42.6	15
24	13	Skenderbeu	280	51	184	143	164	67	66	69	90	1114	42.85	26
25	9	Fan Noli	114	27	85	49	57	26	32	38	39	467	38.92	12
26	20	Skender Çeku	183	24	120	92	102	40	48	37	51	697	38.72	18
27	16	N.Veqilharshi	136	31	104	71	96	41	47	49	55	630	37.06	17
			13406	2264	8810	7121	8526	3119	3668	3429	4309	54652	49.73	1099
		% sipas lëndëve	61	41	62	54	39	57	42	39	44			



REPUBLIKA E KOSOVËS

REPUBLIC OF KOSOVO

REPUBLIKA KOŠOVA

KOMUNA E PEJËS / MUNICIPALITY OF PEJA / OPŠTINA PEĆ



Drejtoria Komunale e Arsimit

DATË/A:	09.07.2025
REFERENC-Ë:	551/29
PËR/ZA/TO:	Kryesuesin e kuvendit Z.Rexhep Kurtbogaj, sekretarin Z.Avni Gashin dhe për Kastriot Belegun
NGA/OD/FROM: DKA	Drejtoria Komunale e Arsimit-Pejë
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Raport për rezultatat e testit të Maturës 2025 në nivel komune

nr	Shkolla	Pjesëmarrja e nxënësve në test	Numri i nxënësve të cilët kaluan testin	Numri i nxënësve të cilët nuk kaluan testin	Përqindja e kalueshmërisë (%)
1	Shkolla e mesme e Mjekësisë	145	135	10	93.1
2	Gjimnazi "Bedri Pejani"	446	393	53	88.11
3	IAAP" Rifat Gjota"	272	139	133	51.1
4	SHMLAA"Odhise Paskali"	72	59	13	81.9
5	SHMLE "Ali Hadri"	60	35	25	58.33
6	Sh e mesme e Muzikës "Halit Kasapolli"	11	8	3	72.72
7	Cambridge School	15	13	2	86.6
8	EuroSchool	70	40	30	57.14
	Totali	1091	822	269	75.34



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA

ZYRA E KRYETARIT
MAYOR OFFICE
URED PRECEDNIKA

KOMUNA E PEJËS
MUNICIPALITY OF PEJA
OPŠTINA PEČ



Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit mbi vetëqeverisjen lokale nr.03/L-40 të datës 20 Shkurt 2008 dhe nenit 52 të Statutit të Komunës së Pejës nr.01/2020 i datës 30 shtator 2020, Kryetari i Komunës, z. Gazmend Muhaxheri, më 09.07.2025, pas shqyrtimit të kërkesës të Drejtoratit për Buxhet dhe Financa, merr këtë:

K o n k l u z i o n

I Propozohet Komitetit për Politik dhe Financa për Shqyrtimin e raportit të hyrave dhe shpenzimeve buxhetore për periudhën Janar – Qershor 2025, që i nijeti material të dërgohet në Kuvend për informim për anëtarët e kuvendit.

Për implementimin e këtij Konkluzioni do të kujdeset Drejtoratit për Buxhet dhe Financa.

Konkluzioni dërgohet:

- Drejtoratit për Buxhet dhe Financa,
- Anëtarëve të KPP dhe
- Arkives.

KOMUNA E PEJËS

I.nr. 400/01-492/2 / 2025
Pejë, 09 korrik 2025





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA

ZYRA E KRYETARIT
MAYOR OFFICE
URLD PRECEDNIKA

KOMUNA E PEJËS
MUNICIPALITY OF PEJA
OPŠTINA PEČ



Në bazë nenit 13 dhe 58 të Ligjit mbi vetëqeverisjen lokale nr.03/L-40 të datës 20 Shkurt 2008 dhe nenit 52 të Statutit të Komunës së Pejës 01/2020 me numër protokolli nr .01-016/01-41343/20 i datës 20 shtator 2020, Kryetari i Komunës, z. Gazmend Muhaxheri me 09.07.2025, merr këtë,

K o n k l u z i o n

I propozohet Komitetit për Politik dhe Financa ta shqyrtoj dhe t'ia rekomandon për Kuvend raportin e punës së Kryetarit të Komunës së Pejës për gjashte mujorin e parë të vitin 2025.

Konkluzioni dërgohet,

- Drejtoratit për Buxhet dhe Financa,
- Anëtarëve të KPP dhe
- Arhives.

KOMUNA E PEJËS

L.nr.400/01 - 49209 / 2025
Pejë, 09 korrik 2025





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA

ZYRA E KRYETARIT
MAYOR OFFICE
URE D PRECEDNIKA

KOMUNA E PEJËS
MUNICIPALITY OF PEJA
OPŠTINA PEČ



Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit mbi vetëqeverisjen lokale nr.03/L-40 të datës 20 Shkurt 2008 dhe nenit 52 të Statutit të Komunës së Pejës 01/2020 me numër protokollit I.nr. 01-016/01-413431/2020 i datës 30 shtator 2020, Kryetari i Komunës, z. Gazmend Muhaxheri më datën 10.07.2025, merr këtë:

K o n k l u z i o n

I propozohet Komitetit për Politik dhe Financa ta shqyrtoj dhe t'ia rekomandon për Kuvend raportin informativ të drejtorisë për Arsimit lidhur me përfundimin e vitit shkollor 2024/2025, testit të arritshmërisë dhe testit të maturës 2025.

Konkluzioni i dërgohet:

- Kuvendit Komunal në Pejë,
- Anëtarëve të KPP dhe
- Arhivës.

KOMUNA E PEJËS

I.nr. 400/01-43205 2025
Pejë, 10 korrik 2025





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA

ZYRA E KRYETARIT
MAYOR OFFICE
URED PRECEDNIKA

KOMUNA E PEJËS
MUNICIPALITY OF PEJA
OPŠTINA PEĆ



Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit mbi vetëqeverisjen lokale nr.03/L-40 të datës 20 Shkurt 2008 dhe nenit 52 të Statutit të Komunës së Pejës 30 shtator 2020, Kryetari i Komunës, Gazmend Muhaxheri, më 30.06.2025, nxjerr këtë:

K o n k l u z i o n

I propozohet Kuvendit Komunal që ta aprovoj nismën për binjakëzim midis Komunës së Pejës dhe Komunës së **Buca nga Republika e Turqisë**.

Për implementimin e këtij Konkluzioni do të kujdeset Zyra e kryetarit dhe sekretaria e Kuvendit në Pejë.

Konkluzioni i dërgohet:

- Zyrës së Kryetarit,
- Kuvendit Komunal në Pejë,
- Anëtarëve të KPF-së dhe
- Arhives.

Lnr. 016/01-45454 /2025
Pejë, 30 qershor 2025

KOMUNA E PEJËS





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA

ZYRA E KRYETARIT
MAYOR OFFICE
URED PRECEDNIKA

KOMUNA E PEJËS
MUNICIPALITY OF PEJA
OPŠTINA PEČ



Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit mbi vetëqeverisjen lokale nr.03/L-40 të datës 20 Shkurt 2008 dhe nenit 52 të Statutit të Komunës së Pejës 01/2020 me numër protokolli L.nr. 01-016/01-413431/2020 i datës 30 shtator 2020, Kryetari i Komunës më datën 10.07.2025, pas shqyrtimit të Raportit të Auditimit të Përgjithshëm për pasqyrat vjetore financiare të Komunës së Pejës për vitin 2024, merr këtë,

K o n k l u z i o n

I REKOMANDOHET Komitetit për Politik dhe Financa shqyrtimi i Raportit të Auditimit për pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Pejës për vitin 2024 dhe plani i veprimit për të gjeturat e auditimit të vitit 2024 dhe procedim të mëtejshëm në Asamblenë Komunale si material informativ.

Për implementimin e këtij Konkluzioni do të kujdeset Shërbimi i Zyrës dhe drejtorati për Buxhet dhe Financa.

Konkluzioni dërgohet,

- Drejtoratit për Buxhet dhe Financa,
- Anëtarëve të KPP dhe
- Archives

L.nr. 016 01-413432 / 2025
Pejë: 10 korrik 2025

KOMUNA E PEJËS

